



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
BASHKIA PATOS

DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 1465 Prot.

Patos më, 15/05/2025



PROJEKT-VENDIM

Nr. 21, datë 15.05. 2025

## PËR MIRATIMIN E BLERJES SË NJË MJETI TRAKTOR DHE FREZË PËR PASTRIMIN E KANALEVE KULLUESE NË TERRITORIN E BASHKISË PATOS

Në mbështetje ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen Civile”, VKM nr. 127, datë 28.02.2025 “Miratimin e projekteve fituese të finançuara për vitin 2025 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të Autoritetit Kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas Njësive të Vetëqeverisjes vendore”, thirrjes “Blerjen e automjeteve për përdorim të veçantë, makina teknologjike dhe mjeteve rrujore të veçanta të përcaktuara si të tilla, sipas parashikimeve të kodit rrugor të Republikës së Shqipërisë të cilat përdoren për përballimin e situatave emergjente të krijuara si pasojë e fatkeqësive natyrore” datë 23.10.2024, aplikimit për financim nëpërmjet shkresës nr. 4207/1 prot., datë 20.11.2024, Ekipi i programit të menaxhimit për të vazhduar me procedurat e mëtejshme,

### KËRKON:

- Miratimin e blerjes së mjetit traktor dhe frezë për pastrimin e kanaleve kulluese me vlerë 12,000,000 (dymbëdhjetë milion) lekë e cila do të financohet nga AKMC.

### EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT

Të Mbrojtjes nga Zjarri dhe shpëtimit dhe Mbrojtjes Civile

Drejtues të Programit

Ermenita MICI

Ermenita MICI

Alket HALIMI

### ANËTARËT

Arben SHPËRDHEJA  
Arlind RUSTO  
Florian TORO

### JURISTE

Nurkë HAZIZAJ



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS

Nr. 1465 Prot.

Patos më, 15/05/2025

### RELACION PËR PROJEKT-VENDIM

#### **PËR MIRATIMIN E BLERJES SË NJË MJETI TRAKTOR DHE FREZË PËR PASTRIMIN E KANALEVE KULLUESE NË TERRITORIN E BASHKISË PATOS**

Bashkia Patos përballet me një problem të vazhdueshmët të pastrimit dhe mirëmbajtjes së kanaleve kulluese, që shërbejnë për menaxhimin e ujit në zonat bujqësore. Kanalet e bllokuara ose të papastruara çojnë në grumbullimin e ujit në toka, i cili shkakton përmbytje dhe dëmtim të kulturave bujqësore, duke ulur produktivitetin e fermerëve dhe duke rritur kostot operacionale. Aktualisht, pastrimi i kanaleve bëhet manualisht dhe mjetet në dispozicion janë të pakta në numër dhe nuk mund të mbulojnë nevojat për pastrim për të gjitha zonat.

Gjatë periudhës 2017-2023 është ndërhyrë në pastrimin e kanaleve kullues të II dhe të III. Megjithëse është punuar vazhdimi i mirëmbajtjen e tyre, mbetet problem serioz rritja e shpejtë e vegjetacionit si ferrat dhe kallamat duke sjellë problematika të ndryshme te fermerët për zhvillimin e bujqësisë.

Për shkak te problematikave të përmendura, lindi nevoja për një investim të ri, i cili ka për qëllim të sigurojë një traktor dhe një frezë të specializuar, që do të përdoren për pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve kulluese. Për këtë, Bashkia Patos ka aplikuar për financim pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për “**Blerje të një mjeti traktor dhe frezë për pastrimin e kanaleve kulluese në territorin e bashkisë Patos**” në kuadër të thirrjes së hapur për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, për “Blerjen e automjeteve për përdorim të veçantë, makina teknologjike dhe mjetet e rrugore të veçanta të përcaktuara si të tillë, sipas parashikimeve të kodit rrugor të Repubikës së Shqipërisë të cilat përdoren për përballimin e situatave emergjente të krijuara si pasojë e fatkeqësive natyrore”. Nga ky proces, Bashkia Patos ka arritur të sigurojë mbështetjen e AKMC për financimin e blerjes së këtij mjeti me vlerë 12,000,000 lekë.

Ky investim pritet të përmirësojë ndjeshmën menaxhimin e ujrave, të parandalojë përmbytjet dhe do të rrisë produktivitetin e tokës, duke ndihmuar fermerët të zhvillojnë një bujqësi të qëndrueshme dhe konkurruese.

Duke pasur parasysh sfidat e paraqitura, ndërhyrja e vazhdueshme me mjetet e pajisje për këtë lloj mirëmbajtje do të ketë impakt shumë të mirë në kullimin e shpejtë të tokave bujqësore në fshatrat e Njësisë Administrative Zharrëz si dhe zonën fushore të bashkisë Patos. Përdorimi i këtij mjeti për pastrimin e vegetacionit do të ndihmojë në sigurimin e funksionimit të qëndrueshëm dhe efikas të sistemeve kulluese, duke përmirësuar njëshëm kullimin e tokave bujqësore dhe duke kontribuar në mirëqenien e komunitetit. Kjo do të reduktojë nevojën për ndërhyrje manuale dhe do të përvisej përshpejtësuar procesin e mirëmbajtjes.

Aktualisht në territorin e Bashkisë Patos, në disa zona ku bujqësia është prioritet dhe e vëmja mënyrë që shumë banorë (fermerë) kryesisht në Njësitetë Administrative të sigurojnë të ardhurat e tyre dhe të familjes së tyre, Bashkia e ka të pamundur që nëpërmjet mjeteve që ka në dispozicion të mund të pastrojnë dhe mirëmbajmë gjithë kanalet kullues në territorin tonë. Investimi për blerjen e një traktori dhe një freze të specializuar për pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve kullues në Bashkinë Patos është një hap kyç në adresimin e sfidave që ka zona lidhur me menaxhimin e ujit dhe mbrojtjen e tokave bujqësore.

**Nisur nga sa më sipër, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:**

- Miratimin e blerjes së mjetit traktor dhe frezë për pastrimin e kanaleve kulluese me vlerë 12,000,000 (dymbëdhjetë milion) lekë e cila do të financohet nga AKMC.
- Për ndjekjen e zbatimin e projekt vendimit ngarkohet Drejtoria e Projekteve dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Financës.

**EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT**

Të Mbrojtjes nga Zjarri dhe shpëtimit dhe Mbrojtjes Civile

Drejtues të Programit

Ermenita MIGI

Alket HALIMI

ANËTARËT

Arlind RUSTO

Florian TORO

Arben SHPËRDHEJA

Florian Duro

KRYETARI

Fation Duro